



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: [edukimi@uni-pr.edu](mailto:edukimi@uni-pr.edu) • [edukimi.uni-pr.edu](http://edukimi.uni-pr.edu)


## **Ekipet e Hulumtimit në Fakultet të Edukimit**

Fakulteti i Edukimit ka zhvilluar një strukturë organizative që synon lehtësimin dhe efikasitetin e proceseve administrative në një anë duke synuar decentralizimin e vendimmarrjes në nivel departamenti, ndërsa në anën tjetër ka themeluar Ekipet e Hulumtimit si struktura profesionale që synojnë zhvillimin e standardit akademik, avancimin e bashkëpunimit kolegjial dhe zhvillimin e bashkëpunimit përtrej departamenteve dhe profileve të personelit akademik.

### **Ekipet e hulumtimit**

Në nivelin profesional, Fakulteti ka themeluar Ekipet e Hulumtimit që bashkojnë profesorët dhe asistentët rreth koncepteve të rëndësishme të studimit të edukimit. Ideja është që mësimdhënës dhe asistentë të fushave të ndryshme të bashkëpunojnë rreth koncepteve të ndryshme të studimit të arsimit. Fillimisht këto ekipe të hulumtimit janë grupe profesionale që organizojnë takime pune për shqyrtim të sillabuseve, ndarje të përvojave në hulumtim, bashkëpunim në projekte të ndryshme shkencore dhe zhvillimore. Ndërsa në fazën e mëvonshme të zhvillimit, këto ekipe do të shqyrtojnë projektet e temave bachelor, master dhe doktoratës si filtri dhe resurs që i shërben departamenteve (puna që aktualisht propozohet ta bëjnë kolegjumet profesionale në departamentin e mësimdhënies lëndore).

Grafiku 2 paraqet ekipet e hulumtimit që funksionojnë në Fakultet të Edukimit, ndërsa më vonë mund të themelohen edhe ekipe të tjera varësisht nga interesimi i zhvillimit të studimeve në fakultet.



Grafiku2. Fushat/tematikat e ekipeve hulumtuese

#### Fushëveprimi dhe përbërja e ekipeve të hulumtimit:

##### 1. Zhvillimi, të nxënët dhe mirëqenia e fëmijëve

Fushëveprimi: Në këtë grup bëjnë pjesë studijuesit e interesuar për të hulumtuar aspekte të teorive të ndryshme të zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve në fushën e zhvillimit fizik, social-emocional, kognitiv dhe të personalitetit; qështje që lidhen me mundësitë, nevojat, potencialet dhe interesat e fëmijëve për të nxënë; Si mësojnë fëmijët më së miri? Cfarë ndikon në të nxënët e tyre më të sukseshëm? Cilët janë faktorët objektiv dhe subjektiv që ndërlidhen me arritjet akademike dhe mirëqenien e fëmijëve dhe adoleshentëve?

Anëtarët:

- Prof. Ass. Majlinda Gjelaj
- Prof. Ass. Rozafa Ferizi-Shala
- Prof. Ass. Vlora Sylaj
- Dr.sc. Blerta Perolli-Shehu
- Dr.sc. Albulena Metaj-Macula
- Dr.sc. Ardit Devolli
- Dr.sc. Adelina Hajrullahu

## **2. Planifikimi dhe implementimi i mësimit**

Fushëveprimi: Në këtë grup bëjnë pjesë studijuesit që kanë interesim për të hulumtuar aspkete të metodologjisë mësimore duke filluar nga planifikimi i strategjive, metodave e teknikave mësimore, pastaj, organizimi i mësimit gjatë etapave të orës mësimore, menaxhimi i klasës, krijimi i klimës pozitive, roli i mësimdhënësit, mjetet mësimore, ambienti motivues për të nxënë deri tek mësimdhënia efektive. Në këtë ekipë adresohen aspektet e per gjithshme didaktike si dhe aspektet e planifikimit dhe implementimit te mësimdhënieve ne fusha të caktuara lëndore. Ky ekip adreson edhe qeshtjet e ndërlidhjes së fushave të caktuara mësimore (STEAM) dhe strategjitë e tjera mësimore si puna me projekte, puna e bazuar në probleme, aspektet ndërkurikulare dhe jashtëkurrikulare etj.

Anëtarët:

- Prof. Asoc. Naser Zabeli
- Prof. Asoc. Hatixhe Ismajli
- Prof. Ass. Arlinda Beka
- Prof. Asoc. Zeqir Veselaj
- Prof. Ass. Arlinda Bytyqi-Damoni
- Prof. Ass. Vlora Syla
- Prof. Ass. Rozafa Ferizi- Shala
- Prof. Ass. Agnese Çanta
- Dr.sc. Jehona Rustemi
- Ligj. Linda Salihu
- Ass. Blerina Tafolli
- Ass. Donika Koliqi
- Ass. Faton Mazreku

## **3. Zbatimi i teknologjisë në mësim**

Fushëveprimi: Në këtë ekipë adresohen mundësitet e integrimit të teknologjisë mësimore dhe digitale në mësimdhënie. Si duhet përdorur ne mënyrë efektive teknologjinë mësimore për mësimdhënie dhe të nxënë? Kur, sa dhe pse duhet përdorur teknologjinë mësimore në të nxënë dhe mësimdhënie? Si mund të mësohen lëndët e ndryshme mësimore përmes teknologjisë? Gjithashtu, studijuesit në këtë grup trajtojnë aspekte të mësimit elektronik, mësimdhënieve në distancë, lehtësimi i të nxënët dhe zhvillimi i aftësive për të nxënë, ndërlidhja midis pedagogjisë dhe përdorimit të teknologjisë si dhe mudnësitet e zbatimit të teknologjisë në nivel të zhvillimit të shkollës dhe sistemit të arsimit në përgjithësi.

Anëtarët:

- Prof. Asoc. Kastriot Buza
- Prof. Ass. Kyvete Shatri
- Prof. Dr. Begzad Baliu
- Prof. Asoc. Myrvete Dreshaj- Baliu
- Prof. Asoc. Atdhe Hykolli
- Prof. Ass. Ardita Devolli
- Prof. Ass. Arlinda Bytyqi- Damoni
- Prof. Ass. Fahri Marevci
- Ass. Dr. Sedat Baraliu
- Ass. Faton Mazreku
- Ass. Jehona Rrustemi
- Ass. Blerina Tafolli

#### **4. Të qenurit mësimdhënës**

Fushëveprimi: Në këtë grup bëjnë pjesë hulumtuesit e interesuar për të studijuar proceset e përgatitjes dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve, probleme rreth rolit të mësimdhënësit në mësimdhëni bashkëkohore, identitetit të mësimdhënësit si dhe raportit të tij me kolegë dhe me akterët e tjera në arsim. Ky ekip trajton edhe aspektet e ndryshme të procesit të të mësuarit e mësimdhënësve, politikave për përgatitjen e mësimdhësve si dhe roli në ndryshim i mësimdhënësve krahas zhvillimit të sistemeve arsimore. Ky ekip adreson edhe aspekete e profilit dhe kompetencave të mësimdhënësit në ditët e sotme dhe pritjeve dhe praktikave të ndryshme në shkollë duke theksuar edhe pritjet e reja për mësimdhënësit si kontribues të zhvillimit të shkollës dhe profesionit. Ekipi trajton dimenzionin e zhvillimit të profesionalizmit të mësimdhënësve duke patur parasysh zhvillimet e ndryshme në fushën e zhvillimit të standardit të profesionit të mësuesisë në vend dhe në nivel ndërkombtar.

Anëtarët:

- Prof. Ass. Blerim Saqipi
- Prof. Ass. Majlinda Gjelaj
- Prof. Ass. Vlora Sylaj
- Prof. Ass. Rozafa Ferizi- Shala
- Prof. Asoc. Bahtije Gerbeshi
- Prof. Ass. Agnese Canta
- Prof. Ass. Kyvete Shatri
- Prof. Ass. Ruzhdi Kuçi

- Ass.Dr. Adelina Hajrullahu
- Ass. Dr. Sefedin Rrahimi

## 5. Politikat arsimore dhe zhvillimi i shkollës

Fushëveprimi: Në këtë grup, studijuesit fokusohen në analizë e politikave arsimore, krahasimin e tyre me vendet e tjera, aspekte të liderishtit dhe menaxhimit efikas të shkollës, partneritetit të shkollës me prindërit dhe komunitetin, raportet kolegiale dhe zhvillimit të kulturës organizative në shkollë si dhe zhvillimi dhe menaxhimi i projekteve zhvillimore në shkollë në kohën e ndryshimeve të mëdha shoqërore, politike dhe teknologjike e shkencore. Ky grup poashtu studjon aspektet e planifikimit dhe menaxhimit të ndryshimeve në nivel të shkollës dhe sistemit me theks të vecant të kuptuarit e reformës arsimore dhe zhvillimit të politikave arsimore.

Anëtarët:

- Prof. Ass. Blerim Saqipi
- Ass.Dr. Albulena Metaj
- 

## 6. Kurrikulat dhe tekstet mësimore

Fushëveprimi: Në këtë grup bëjnë pjesë mësimdhënësit të cilët kanë interesim për studimin e politikave kurrikulare dhe praktikave të zhvillimit të kurrikulave. Grupi poashtu adreson temën e cilësisë dhe funksionit të teksteve shkollore dhe krijimin e zbatimin e resurseve tjera mësimore.

Anëtarët:

- Prof. Asoc. Hatixhe Ismajli
- Prof. Asoc. Zeqir Veselaj
- Prof. Dr. Begzad Baliu
- Ass. Dr. Sedat Baraliu
- Prof. Asoc. Kastriot Buza
- Prof. Asoc. Atdhe Hykolli
- Prof. Ass. Arlinda Bytyqi- Damoni
- Prof. Ass. Arlinda Beka
- Prof. Asoc. Myrvete Dreshaj
- Prof. Ass. Ruzhdi Kuçi
- Prof. Ass. Fahri Marevci
- Ass. Dr. Valentina Nimonaj

## **7. Inkluzioni dhe diversiteti**

Fushëveprimi: Në këtë grup bëjnë pjesë studijuesit të cilët duan të merren me aspekte të planifikimit dhe zbatimit të mësimdhënies gjithpërfshirëse, përfshirjes së nxënësve me nevoja të vecanta dhe atyre të talentuar në arsim dhe integrimit të tyre në shoqëri, përfshirjes së fëmijëve pavarësisht ndryshimeve që kanë midis vete në aspektin social, ekonomik, kombëtar, kulturor, fetar e racor. Në këtë grup studijuesit synojnë të identifikojnë edhe praktikat më të mira të respektimit të diversitetit dhe vlerave të tjera të demokracisë, përtej vështirësive në të mësuar.

Anëtarët:

- Prof. Asoc. Naser Zabeli
- Ass. Dr. Blerta Perolli- Shehu
- Prof. Ass. Ardit Devolli
- Prof. Asoc. Bahtije Gerbeshi
- Ligj. Linda Salihu
- Ass. Donika Koliqi

## **8. Vlerësimi në arsim**

Fushëveprimi: Në këtë grup zhvillohen hulumtime mbi llojet e ndryshme të vlerësimeve në arsim, efektet e vlerësimit në ngritjen e cilësisë në arsim, mësimet e nxëna nga testimet ndërkombe të PISA, TIMS, etj), vlerësimi i performancës së mësimdhënësve, vlerësimi i programeve, ndryshimi i arsimit përmes ndryshimit të vlerësimit etj. Grupi trajton aspektet e planifikimit, zbatimit dhe shfrytëzimit të vlerësimit (formues dhe përbledhës) në fusha të ndryshme kurrikulare si dhe ndërlidhjen e vlerësimit me procesin e planifikimit dhe metodologjisë së mësimdhënies.

Anëtarët:

- Prof. Ass. Majlinda Gjelaj
- Prof. Asoc. Naser Zabeli
- Prof. Asoc. Hatixhe Ismajli
- Prof. Asoc. Kastriot buza
- Prof. Asoc. Atdhe Hykolli
- Prof. Ass. Arlinda Damoni
- Prof. Ass. Arlinda Beka
- Ass. Dr. Adelina Hajrullahu

- Ass. Blerina Tafolli
- Prof. Ass. Kyvete Shatri
- Prof. Ass. Ruzhdi Kuçi
- Prof. Ass. Fahri Marevci
- Ass. Dr. Sefedin Rrahimi
- Prof. Ass. Agnesa Çanta

## 9. Arsimi, shoqëria dhe vlerat në arsim

Fushëveprimi: Në këtë grup bëjnë pjesë hulumtues të interesuar në fushën e filozofis dhe sociologjisë së arsimit dhe ndërlidhjes së arsimit dhe shoqërisë. Grypi poashtu studjon edhe aspekte të ndryshme kulturore dhe sociale dhe ndërlidhjes së tyre me mësimdhënen dhe të mësuarit. Efektet që ka ndryshimi i familjes, gjinia, raca, kombësia, multikulturalizmi, demokracia dhe kërkesat e kësaj shoqërie ndaj shkollimit dhe mësimdhëniec. Zhvillimi i qytetarisë demokratike, zhvillimi i vlerave përmes edukimit dhe shërbimit të edukimit në të mirë të zhvillimit të shoqërisë janë disa nga konceptet tjera që trajtohen nga ky grup i hulumtimit.

Anëtarët:

- Prof. Ass. Blerim Saqipi
- Prof. Dr. Begzad Baliu
- Prof. Asoc. Zeqir Veselaj
- Ass. Faton Mazreku
- Ass. Dr. Sefedin Rrahimi
- Ass. Dr. Sedat Baraliu
- Prof. Asoc. Bahtije Gerbeshi